

Fadil Sulejmani

DISA TË DHËNA RRETH LINDJES NË MALËSINË E TETOVËS (II)

Krahas riteve e zakoneve të lindjes, si fjala vjen, *shtatzëna*, *lehona* (llahujza), *foshnja* (lireki), të cilat i trajtuam në pjesën e parë të këtij punimi, në Malësinë e Tetovës përcillen edhe me rite e pokushe të tjera, që cilësohen me karakterin e tyre pagan. Sidomos do të bëhet fjalë për *kokrrat* (kokat), *babinat*, *fëmija*, (caulla) dhe për disa këngë të djepit.

Kokrrat (Kokat)

Menjëherë atë ditë si të lindet fëmija i parë, pa marrë parasysh nëse është djalë apo vajzë, i çojnë dy — tre fëmijë për të marrë sihariqin (mizhden) te të afërmit e lehonës dhe të burrit të saj. Një fëmijë shkon e lajmëron te prindërit e lehonës, një tjetër te farefisi i burrit të saj dhe të tretin e dërgojnë nëpër shtëpitë e lagjeve. Fëmijët shkojnë me dëshirë të madhe për të përhapur lajmin e gëzueshëm të lindjes së fëmijës, sepse për këtë ata i shpërblejnë me diçka: japin ndonjë dinar, ndonjë kokërr vezë apo pemë etj. Fëmijët e marrin sihariqin me këto fjallë: „Mizhde se nausja lalës NN ka ba gjal / cauc!” Ose: „Mizhde se nausea lalës NN i ka lije ni gjal / ni cauc!” Por edhe: „Mizhde se nauses lalës NN i ka lije ni caull”.

Në MT është zakon që kur lindet fëmija, ziejnë kokrra misri, por edhe gruri, që në këtë anë u thonë thjesht „koka”. Thuhet: „Kur liën caulla e par, viën koka / zin koka”. Por dihet se çfarë „kokash”: kokrra misri (kollomoçi) ose gruri (gjruni) i Aty këtu sipas familjeve e katundeve (në Veshallë) kokrrat i përziejnë misër e grurë me qëllim që t’u përzihen fëmijët: të linden edhe djem edhe vajza. Kokrrat i ziejnë ditën e dytë të lindjes së fëmijës, por bën edhe ditën e parë, nëse ai është lindur në mëngjes. Në Bozovcë kokrrat i shpërndajnë fëmijët nëpër katund: çdo shtëpie i çojnë nga një safë me kokrra, duke lajmëruar se filanja ka lindur djalë ose vajzë. Në Novosellë, Rakovec e Sellcë të Keqe kokrra shpërndajnë vetëm nëpër shtëpitë e lagjeve dhe të farefisit. Fëmijëve që derdhin kok-

rrat e foshnjës u futin në sahan e safë ndonjë kokërr veze, ndonjë dinar, ndonjë pemë ose ndonjë copë (kaçajt) bukë sa për të mos ua kthyer thatë enën e kokrrave. Bukë u jepnin sidomos në ato kohë të kaluara, kur ajo ishte me këllëk në këtë anë. Përndryshe, fëmijës i ziejnë kokrra me qëllim që t'i shtohet nafaka atij. Në përgjithësi për çështje bereqeti: si anëtar i ri i familjes të rritet me bereqet në atë shtëpi. Pikërisht për këtë arsye ata nuk ziejnë kokrra vetëm për fëmijën e parë, por edhe për të dytin, të tretin, të katërtin e kështu me radhë për të gjithë të tjerët pa marrë parasysh nëse është djalë apo vajzë. Në disa katunde të tjera si në Shipkovicë, Veshallë, Sellcë etj. kokrrat nuk i shpërndajnë as nëpër lagje as nëpër katund, por farefisi vijnë e hanë aty kokrra në shtëpinë e të lindurit.

Në të gjitha katundet e MT atë ditë që vihen kokrrat e fëmijës së parë organizohet nga familja e të lindurit edhe një lloj banketi, ahengu, që në këtë anë e quajnë „zefk-i”. „At dit xhi viëm koka bajm ene zefk pi qefit xhi na ka lije caulla”. Në këtë aheng ftohen kryesisht gratë, si nga të afërmit e babait të fëmijës së lindur, ashtu edhe farefisi i lehonës. Të ftuarve, pos kokrrave, u vënë të hanë edhe fli, ndridhe, petulla hiq e piq, kollpite, fasule etj. Nga kokrrat që u vënë të ftuarve nja dy — tri sosh ia japin më parë që t'i hajë lehona me qëllim që të ketë tëmbël dhe pastaj ua vënë të tjerëve. Nëse banketi është bërë për lindjen e djalit, atëherë gëzimi e hareja marrin përmasa më të gjera. Ndër të tjera, u bien edhe dajreve, këndojnë e vallëzojnë, kryesisht të rejat: vajzat dhe nuset. Këngët që këndohen me këtë rast kanë të bëjnë kryesisht me gëzimin e prindërve që u ka lindur djalë, me përhajrimin (urimin) e tij etj.

*Hajni elbebija koka gjruni,
 NN agës i ka lije çuni!
 Hajni shiqerpare me shiqer,
 Hajrli t'koft gjali, o NN dilber!
 Hajni koka n'odën me dollap,
 hajrli t'koftë çuni mori nana plak!
 Hajni koka n'odën me shishe,
 hajrli t'koftë çuni mori nana xhishe!*

Nëse lehona e ka kumatën me barrë ose të re që pritët të bëjë fëmijë, atëherë këndojnë këngë të tilla, që theksojnë se ajo ia ka lëshuar rendin asaj, kumatës së vet si:

*Hajni kokat e Hasanicës,
 ja la rendin Hisenicës.¹*

¹ Në MT të gjitha femrat e mantuara, nuse e gra, nuk thirren me emrin e vet, por me emrin e burrit të vet, duke i shtuar prapashtesën sllave — ica: Hasan + ica = Hasanica, që do të thotë nusja ose gruaja e Hasanit.

E këndojnë edhe vetë djalin ose të ëmën e tij, lehonën, që ka shpëtuar nga lindja si:

*More gjali vojl majr se na ke ardh,
kofsh me nafake e paç kamën e mar;
ene na u rrjtsh me bab'e me nan,
ene me shaum mall, ene ma shaum xha.*

*Ani hajni koka pa teklij,
shiqir Hasanica xhi a kurtalis.
Ipni Hasanics çaj mali,
se kijtoj kollaj liën gjali.*

Pos këtyre këngëve që kanë të bëjnë me lindjen e djalit, me këtë rast këndohen edhe këngë të tjera: këndojnë kryesisht djemtë që i kanë për martesë, të fejuar, kunetët e lehonës që janë për t'u martuar, djemtë e tjerë të vegjël që janë për t'u bërë synet, ndonjë djalë tjetër të farefisit të burrit, ndonjë nuse të fejuar (t'zanme) etj.

Me rastin e lindjes së vajzës gëzimi është i vogël dhe ahengu bëhet sa për sy e faqe, sa për adet: nuk u bien dajreve, nuk vallëzojnë, as nuk këndojnë këngë. Sikur edhe të këndohet në ndonjë familje, këndojnë këngë që kanë të bëjnë me djemtë e fejuar të asaj shtëpie, me djemtë që i kanë për t'i bërë synet etj. Vetë vajzën e lindur në asnjë mënyrë s'e këndojnë siç ndodh në të kundërtën me djalin.

Të ftuarit që vijnë në kokrrat e foshnjës e daritin atë me ndonjë dinar: dikush më shumë e dikush më pak, sipas mundësisë e farefisnisë që kanë me të. Ata njëkohësisht ua urojnë foshnjën të afërmeve të saj. Për djalë thonë: „Hajrli u koft gjali! Me imër koft e me nafake! E past babën e nanën! U kana shtaue ni pushk!” Kurse për vajzën thonë: „Hajrli u koft cauca! Koft me nafake! E past babën e nanën! Te ka lije cauca do lije ene gjali. Cauca liën me shtat nafake!”² Për djalin e prekin njëkohësisht edhe hekurin me qëllim që të jetojë shumë si ky metal, kurse për vajzën jo. Të gjithë atyre që vijnë për të ngrënë kokrra, nuk ua zbulojnë foshnjën, sepse druajnë se po ua marrin mësysh. Të ftuarit e dinë këtë gjë, prandaj as që kërkojnë ta shohin foshnjën. Mund të kërkojë dhe ta shehë foshnjën vetëm farefisi i saj i ngushtë. Pas kokrrave foshnjës ia bëjnë babinat.

Babinat

Si kokrrat, ashtu edhe babinat janë një lloj shendi që bëhet me rastin e lindjes së fëmijës, por në përmasa organizative shumë më të thella se kokrrat. Për kah koha babinat mund t'i bëhen fëmijës nga java e parë e lindjes së tij e deri sa të mbushë një motmot. Nëse

² Të vihet re këtu se si vajzës nuk i urojnë jetë: nuk thonë sikurse për djalin „Me imër koft!”, por vetëm „Koft me nafake!”

fëmija i lindur është vajzë, nguten që babinat t'ia bëjnë sa më shpejt, madje brenda javës, duke mos lejuar që të zgjatë shumë kohë, sepse në të kundërtën besohet se zgjat lindja e vajzave d.m.th. fëmijët e tjerë pasë saj do të lindin vajza. Pra, babinat ua bëjnë menjëherë vajzave me qëllim që të shkurtohet lindja e tyre. Përkundrazi kur fëmija i lindur është djalë, babinat ia vonojnë shumë, duke ia zgjatur në kohë deri gjashtë muaj apo një motmot pas lindjes me qëllim që të zgjatë lindja e djemve, d.m.th. edhe fëmijët e tjerë pas tij të lindin djem. Përndryshe, babina u bëhen vetëm fëmijëve të parë, qoftë vajzë apo djalë, me përjashtim të katundeve Novosellë, Rakovec e Sellcë të Keqe, ku babina i bëhen, pos fëmijës së parë, edhe të dytë e të tretë. Si në kokrra, ashtu edhe në babina, ftohen dhe shkojnë vetëm gratë. Babinat bëhen ditën e hënë ose të enjten, të cilat meren si ditë më të lëvduara në këtë anë. Ftohen gratë nga të dy palët e prindërve të foshnjës: edhe nga farefisi i nanës edhe nga ai i babait. Të afërmit e anës së burrit i fton dikush nga familja e tij, kurse të afërmit e anës së gruas, lehonës, i fton e ëma e saj, të cilën e autorizojnë në këtë punë: kë do ajo prej anës së vet mund ta grishë e ta sjellë në babinat e nipit apo të mbesës së saj. Ajo ka të drejtë t'i sjellë në babina prej palës së vet deri 30 veta gra ose një numër të pakufizuar sosh. Në katundet Novosellë, Rakovec e Sellcë të Keqe të gjitha gratë e katundit pa dallim farefisnie e miqësie shkojnë pa u ftuar në babinat e fëmijëve. Gratë e këtyre katundeve, si të marrin vesh përmes njëra tjetrës se filanja këtë apo atë ditë i bën babina fëmijës që të gjitha çohen e shkojnë pa i thirrur askush, sepse po qe se ndonjëra nuk shkon, i mbetet hatri zonjës së shtëpisë, e cila pastaj nuk i shkon asaj gruaje që ka munguar, kur t'i bëjë babinat e fëmijës së vet në të ardhmen. Të gjitha gratë e ftuara nga të dy anët i sjellin diçka foshnjës e lehonës dhe një rëzve të tjerë të shtëpisë së tyre me rastin e babinave, por sipas mundësisë e lidhjes së gjakut që kanë me familjen e lehonës apo të burrit të saj. Dikush sjell një sahan me petulla në të lye, me petulla hiq e piq, me kollpite, me fli, me ndridhe, gurabija etj. në të kaluarën sidomos, kurse sot çojnë edhe ndonjë ëmbëlsirë si sheqerpare, alygyn, tatli, ravani, ndonjë qese sheqer etj. Sidomos e ëma e lehonës duhet të çojë ëmbëlsirë, të cilën madje ua qesin grave të ftuara për ta ngrënë. Disa gra të tjera çojnë si bakshish vetëm rroba fëmijës si një këmbishë, një palë çorapë, një fes, një fanellë, një mintan, një çevre, një xhamadan etj. dhe lehonës si një këmbishë, një shami, një jelek, një kombinezon, një palë nalle etj. Ato gra që janë të afërta me familjen e foshnjës çojnë edhe sahan edhe peshqeshe njëkohësisht. E ëma e lehonës, pos ëmbëlsirës që sjell, ajo u çon nga një kat tesha komplet fëmijës dhe lehonës. Ajo burrit të së bijës, dhëndrit, i çon një çevre ose një këmbishë dhe vjehrrit të saj një marhamë e vjehrrës një shami. Gratë e ftuara shkojnë në babina pak kohë paradreke dhe rrinë atje nja dy tri orë, deri kah iqinia. Ato del dhe i pret te dera e oborrit vjehrra e lehonës me disa gra të tjera të lagjes ose të fare-

fisit. U thonë: „Majr se erdhe / erdhët!” Ato u përgjigjen: „Majr se xhem (gjejmë)!” Pastaj i çojnë në dhomën ku është lehona, e cila atë ditë ndërrohet me teshat më të reja e më të bukura që ka e bie në shtrat, prej nga u dëshiron mirëseardhje grave, por pa u çuar nga ai. Si është thënë, ajo s’guxon t’i marrë në grykë gratë, sepse i ikën tëmbli. Këtyre grave s’ua shplojnë ta shohin as foshnjën, sepse merr mësysh. Çdo njëra nga këto gra ua përhapron foshnjën, duke e daritur me ndonjë dinar. Ato e pyetin njëkohësisht edhe lehonën se si është me shëndet dhe me qumësht. Rregullisht në babina për gratë e ftuara përgatitet edhe haje, e cila shtrohet sipas këtij rendi dhe lloji: groshë, sarmë, jahni (mish me patate), birjan, një ëmbëlsirë që ka sjellë e ëma e lehonës dhe sytliaç (oriz me shiqer). Në të kaluarën pasuria e gjellëve ka qenë kjo: fasule, sarmë, jahni, kollpite, ndridhe të kalamboqtë, petulla në fultere ose hiq e piq, hallvë dhe tëmbëloriz. Në katudent Novosellë, Rakovec e Sellcë të Keqe, meqenëse numri i grave është i madh, vijnë të gjitha gratë e katundit, kurse mundësitë e vogla ekonomike të katundarit të këtij regjioni, numri i gjellëve që u vihen grave në babina, si dhe në Bajramllëk, të fejesës së vajzës, arrin deri në tri lloje: fasule, mishelakra dhe hallvë. Nga të gjitha gjellët më parë (sefte) ende pa u vënë në sofër, marrin nga pak dhe i japin lehonës që t’i vijë tëmbli, përkatësisht të mos mashtrohet e t’i ikë ai. Pasi hanë bukë, gratë pinë nga një kafe dhe çohen të gjitha menjëherë për t’u kthyer nëpër shtëpitë e veta. Atyre grave që kanë shkuar me sahanë, u futin në ta pak nga ushqimet e babinave sa për të mos ua kthyer thatë. Gratë i përcjellin po ashtu deri te dera e oborrit, duke i thënë çdo njërës „Udh’e mar!” Ato përgjigjen „Meç / meçi t’majr!” Edhe lehona u dëshiron rrugë të mbarë, por nuk çohet nga shtrati për t’i përcjellë dhe për t’i marë në grykë, sepse i humb tëmbli.

Babinat zgjatin vetëm një ditë dhe në to nuk këndohet, nuk u bien dajreve dhe nuk vallëzojnë. Megjithatë, sot aty — këtu në babina dëgjohet edhe kënga e dajrja, por vetëm për lindjen e djalit. Këndojnë kryesisht djemtë e farefisit që janë të fejuar, për martesë ose për synet. Por këndojnë edhe ndonjë këngë që është e lidhur me foshnjën, fëmijën.

*He mori ju gjra pi ka nana,
naj thojni gjalit mashalla;
he mori ju gjra pi ka baba,
naj thojni gjalit mashalla.
Thojni mashalla mo marre msajsh
se a si lulja, o tu u rrajt;
thojni mashalla se derxhën
se a si lulja kur çelën.*

*He mori ju gjra me openga
daritne gjalin pi te dera,*

*ani pi te dera pa e pa,
se a i vojl e merr msajsh.*

Ndonjë këngë ka të bëjë me ardhjen e grave në babina dhe me përcjelljen e tyre.

*He mori ju gjra me potina,
majr se na edhët n'babina!*

*He mori ju gjra u koft udh'e mar,
kini ardh n'babina për façe t'bardhë;
për façe t'bardhë e për qefin tonë,
njefshna va thkefshna, o për fomojnë.*

Babinat e foshnjës i ndeshim edhe ndër popuj të tjerë të Ballkanit, ku, në mes të tjerash, i këndohet edhe foshnjës edhe lehonës.³

Fëmija (Caulla)

Në MT fëmija nuk njihet me këtë emër, por me fjalët „caull-a (cull)nj. dhe sh. „caullët”. Derisa foshnja është në djep, përkatësisht në pelena, e quajne „lirek” dhe përfshin një kohë prej lindjes e deri sa ajo fillon ta njohë e ta kuptojë pak a shumë ambientin që e rrethon: të ëmën dhe njerëzit tjerë të afërm të familjes, nis të qeshë me ta, të kapë me dorën e vet gjësende të ndryshme, t'ua japë duart, të zhargitet për toke, të gugatë e të shqiptojë fjalët e para „mama” e „baba”, pasthirrma të ndryshme e të shfaqë aktivitete të tjera fizike e mentale. Pra, pas disa muajsh si të bëhet foshnja e tillë që me gjallërimin e saj shpirtëror dhe me veprimet intenzive të lëvizjeve të gjymtyrëve të trupit dhe të artikulimit të rrokjeve e të fjalëve, të tërheqë vëmendjen e të pranishëmve, atë në këtë anë nuk e quajne më foshnjë (lirek), por fëmijë (caull). Me emrin „caull-ë-t” në këtë anë kuptojnë edhe gruan, bashkëshorten. Në MT përdoret edhe fjala „fomoj”, që s'e ka kuptimin e fjalës fëmijë (caull), por atë të fjalëve bir, bijë, djalë e vajzë, duke i treguar këto në raport familjar si pronë që i takojnë një pronari të caktuar, prindërve të vet si „Fomoja jote nauk a haram. Fomoja a e dhajmshme. Fomojn nauk e duën keç baba e nana. Fomojt tauj jan t'majr”. Sidoqoftë, edhe jeta e fëmijës duke vazhduar nga ajo e foshnjës është e mbushur me plot pokushe dhe adete, që kanë për qëllim ruajtjen e tij nga mësytë, nga qoftëlargu, nga sëmundjet etj. Një numër sosh janë të lidhura drejt për drejt me shëndetin e fëmijës, me të ecurit, me të folurit etj.

³ Sh. V. Karadžić, *Srpske narodne pesme*, f. 190—191.

Pokushe të shumta e të ndryshme i bëhen atij fëmije që nuk ka rritje të mbarë e zhvillim normal të trupit, si në pikëpamje fizike, ashtu edhe në atë mentale. Si foshnjën, ashtu edhe fëmijën nuk bën ta kapërcejnë të vjetrit, rritja e të cilëve ka pushuar, sepse pastaj edhe ai nuk rritet. Por njerëzit e rinj, që janë duke u rritur, mund ta kapërcejnë, sepse ata rriten, gjë që s'e pengon rritjen e fëmijës. Një ditë para ditës së Shën Gjergjit, që në këtë anë e quajnë „dita e trafkave” (nga maq. trava + ka > trafka = kullojë) fëmijët i lajnë me lule e elbarozë, që në këtë anë e quajnë sipas maq, zdravec (*Geranium macrorrhizum*),⁴ duke i fërkuar kah kryet e kah trupi me një vezë me qëllim që t'u ecë shëndeti: të rriten të pashëm si lulet dhe të rrumbullaksohen e të zbardhohen si veza. Gjithashtu për çështje shëndeti e çojnë fëmijën te ndonjë burim i ujit të thartë dhe e lajnë në natyrë me ujë të ftohtë mineral. Kështu veprojnë kryesisht me fëmijët shëndetligj me qëllim përmirësimi. Ndonjë fëmijë që është tejet i ligshhtë me shëndet, që ka ngelur shumë prapa në pikëpamje të zhvillimit fizik përkundër moshatarëve të vet dhe vjetëve që ka bërë, nuk rritet, nuk shton, që, siç thonë këndej, „nauk a as i ksaj dunjaje, as i asaj dunjaje”, e çojnë te varri i paditur (te vorri paditëm), qoftë te varret e katundit të vet, qoftë te varret e huaja, të ndonjë katundi tjetër. Në këtë anë thuhet se foshnjën nuk duhet lënë vetëm, diku pa i mbushur 60 ditë, diku 40 ditë e diku pa i bërë tre muaj, sepse kur është ai vetëm, vijnë qoftëlargët, shpirtërat e këqij, dhe e ndërrojnë me fëmijën e vet: „E lan t'vetin, e marrin tanin”. Për këta fëmijë shëndetligj besohet se janë të ndërruar, dmth. nënat e tyre da t'i kenë lënë vetëm pa i mbushur ditët e caktuara të foshnjërisë dhe kanë ardhur qoftëlargët e ua kanë ndërruar, këmbyer me fëmijët e vet. Prandaj për t'i shkëmbyer këta fëmijë të këmbyer, duke marrë fëmijën e vet e duke lënë atë të qoftëlargut, e ëma së bashku me një grua tjetër, e çon fëmijën shëndetlig te varri i paditur. Fëmijën e çojnë te varri në mëngjes herët dhe për këtë s'i tregojnë askujt. Atë e vënë mbi varr ose pranë tij në shpinë dhe në formë të kryqëzuar, duke bërë kryq me varrin, që do të jetë një pokush i ruajtur nga krishterimi, nga ato kohë, kur banorët e kësaj ane ishin besimtarë të këtij religjioni. Fëmijën e lënë duke bërë bismilahe e duke thënë tri herë këto fjalë: „Mirrne tujin e na e bini tonin!” Ose: „T'majrin xhi na e kini marr, bine; t'keçin xhi na e kini prau, mirrne!” Dikush tjetër thotë: „Na d'drujtin e bere t'hekërtin!” Pastaj largohen nja dhjetë metra nga fëmija e fshehen në ferra, duke e lënë atë të rrijë vetëm nja pesë minuta. Nëse fëmija qan, besohet se qoftëlargët e prunë fëmijën e tyre dhe e morën të vetin, meqenëse fëmija e sheh atë dhe qan pas tij. Mirëpo, nëse fëmija nuk qan, atëherë besohet se s'ka ardhur qoftëlargu për ta sjellë fëmijën e huaj e për ta marrë të vetin dhe nuk shpresohet më në këtë fëmijë se do të bëhet diçka, përkundrazi pre-

⁴ *Rečnik na makedonskiot jazik I*, Skopje 1961, f. 256.

sin që ai do të vdesë, sepse nuk mund të jetojë me njerëzit fëmija i qoftëlargut. Pastaj e marrin fëmijën dhe kthehen në shtëpi me besim të plotë se do të përparojë fizikisht nëse ka qajtur, dhe në të kundërtën pa kurrfarë shpresash për jetë të tij. Sipas disa katundeve e familjeve fëmijën e çojnë te varri i paditur tri vajza të reja, të cilat janë duke u rritur e të shëndetshme me qëllim që edhe fëmija të fillojë të rritet e të bëhet i shëndetshëm si ato. Fëmijëve shëndetligj ditën e Shën Gjergjit u kthejnë edhe plithar me qëllim që t'u kthehet shëndeti. Nëse plithari del me ndonjë gjallesë si skra, thnegël, krimb etj., dmth. është i mbushur, besohet se edhe fëmija do të mbushet me shëndet, por nëse plithari del i thatë, atëherë nuk shpresohet në përmirësimin e shëndetit të tij. Rrallë ndodh që të dalë plithari i thatë, sepse në këtë kohë toka (dheu) është e mbushur me këso gjallesash.

Një numër pokushesh kanë të bëjnë me shërimin e sëmundjeve të ndryshme, si të fëmijës, ashtu edhe të foshnjeve. Kur fëmijës i dalin puçrra të ndryshme nëpër trup apo fytyrë, që në këtë anë i quajnë me emrat „kokat e kuçe, e shkumja e pulave, lija e çenit etj.” atë e çojnë dhe e lajnë në kufi (sinaur) të një vendi të huaj me qëllim që t'i lahen e t'i mbeten atje ato. Ujin me të cilin do të lahet fëmija e mbushin pa folur në një gjygyt të bakërt qysh në mbrëmje. Mbi gjygyt me këtë ujë vënë një fshisë (netëll), mashën e zjarrit, kacinë e tri ceza (cefka nga maq. cevka) dhe e lënë pas derës së dhomës të rrijë gjithë natën. Të nesërmen në mëngjes e ngrohin këtë ujë dhe e marrin fëmijën e shkojnë dhe e lajnë atje ku kufizohet vendi i dy katundeve „n'sinaur t'huj”. Fëmijën e lajnë kryesisht ndër ndonjë ferrë ose murriz me fjalët: „Me nijet t'zotit e kimi prau ket caull, lirek, ta lajm ktau e t'i lahen kokat”. „T'kçijat e t'ligjat i lashna e t'majrat i marrshna!” „Kokat i lam, e murçm caullën, lirekin!” Mandej e fshijnë ia marrin ujin fëmijës, me këmishën e vet, të cilën pastaj e fugin në ferrë, duke thënë: „Kokat e t'kçijat e ksaj caulle, t'ktij lireki, metshin napër ferra”! Aty këtu, sipas familjeve e katundeve, kur fëmijët mbushen me një lloj puçrrash, që në këtë anë i quajnë „e shkumja e pulave”, atëherë i lajnë te dera e nevojtores ose e kotecit të pulave me qëllim që të këqijat (puçrrat) e tyre të lahen me ujin e të shkojnë te të këqijat: te nevojtorja, përkatësisht te glasat e pulave nga e kanë marrë këtë sëmundje. Fëmijën e lajnë me ujin që e ngrohin përmes një shati ose kazme, që e nxehin në zjarr deri në atë masë sa skuqet dhe pastaj e zhytin në ujë, por vetëm një herë. Me këtë ujë të ngrohur në këtë mënyrë e lajnë fëmijën, duke thënë: „Sebep pi ksaj e derma pi zotit”. „T'kçijat e kokat e ksaj caulle, t'ktij lireki, shkofshin te t'kçijat e qenefit e t'pulave”. Kur ndonjë fëmije i del lunga e marrin atë dhe ia „streditin” (nga sllav. srediti — rregulloj) me anë të disa veprimeve të fshehta që kanë për qëllim t'ia humbin atë, t'ia zhdukin. Këtë pokush mund ta bëjë vetë e ëma e fëmijës nëse e di ose ndonjë grua tjetër, të cilës për këtë punë i ka dalë emri në katund. Në një ditë të marte kah mbrëmja, duke rënë

terri, e marrin fëmijën dhe e qesin në një strehë të shtëpisë dhe ia „streditin” lungën me një krahër, me një thikë, me një kaci, me një fshisë, me pëgatë dhe me tre guraleca, por pa parë askush, sepse atëherë nuk zihet pokushi. Me krahër e prekin tri herë lungën e fëmijës dhe tokën me qëllim që t’ia krehin e t’ia futin në tokë, duke i thënë: „Hup se t’hupa!” Po kështu veprojnë edhe me thikën, kacinë e fshisën, duke e prekur me to tri herë lungën dhe tokën me qëllim që atë ta presin me thikë, ta fshijnë me fshisë dhe pastaj ta dëlirin me kaci e ta fugin në tokë. Pastaj marrin një krande dhe po ashtu e prekin tri herë lugën, pëgatën (t’fllajmin) dhe tokën, duke thënë: „Hiçe t’fllajm t’fllajmin!” Pas kësaj marrin tri guraleca dhe me çdo njërin e prekin nga tri herë lungën dhe tokën, duke thënë: „Hup se t’hupa!” Secilin gur, duke e lënë në tokë, e kthejnë mbrapsht me qëllim që edhe lunga të kthehet mbrapsht, të humbë. Kështu veprojnë tri të marte me radhë me qëllim që të merret lunga dhe në mbrëmje „tue u mshel akshami” me qëllim që të mëshelet lunga.

Nëse fëmija është mbushur kah duart me lytha (letha) marrin dhe ia „streditin” me ujë të shiut, që është mbledhur nëpër gropa të vogla mbi ndonjë shkëmb, kep, gur. Me një guralec tri herë e prekin ujin e shiut dhe lethat, duke u thënë: „Hupni se u hupa!” Kur fëmijëve ose foshnjave u bie kolli, që në këtë anë e quajnë, herë „kolli keç” e herë „kolli majr”, atyre ua varin një gështenjë të egër në shul të djepit ose në qafë, duke besuar se ajo do t’ua largojë atë ose të pakën do t’i mbrojë që të mos i mundojë shumë.

Nëse fëmija gërhet besohet se nëna e tij, kur ka qenë me barrë me të, do t’i ketë rënë maces me shqelm dhe për këtë arsye fëmija i gërhet si macja. Për ta shpëtuar fëmijën nga kjo sëmundje e maces duhet ta çojnë atë te prindërit e të ëmës, përkatësisht te lagjja ose te katundi i saj, për t’ia sharruar një dru mbi krye me qëllim që t’i sharrohet gërhatja, e keqja. Fëmijën e merr njëri nga dajët e tij ose dikush tjetër nga të afërmit e nënës së tij dhe e çon te dera e xhamisë, ku merr një dru të gjatë dhe e mat me të trupin e fëmijës. Atë pjesë që del më e gjatë se fëmija e sharron me sharrë, duke besuar se kështu po sharron edhe sëmundjen e nipit ose të mbesës.⁵

Një pjesë e pokusheve janë të lidhura me mbrojtjen dhe çlirimimin e fëmijëve nga mësytë. Nëse foshnja apo fëmija qan shpesh, madje edhe në ato raste kur trembet në gjumë dhe ia shpërthen vajit, besohet se atë e kanë marrë mësysh. Prandaj në atë kohë që ia plas vajit, qoftë ditën apo natën, e marrin dhe e lajnë për t’ia hequr të keqen që e mundon në shpirt. Ata për këtë qëllim më parë i fikin gaca fëmijës. E mbushin një kusi me ujë për ta larë fëmijën dhe e vënë në zjarr për t’u ngrohur. Në këtë ujë i fikin tri gaca, duke thënë: „sojzivi”, kur e fikin gacën e parë, „sojbardhi”, kur e fikin të dytën dhe „sojshkraumi”, kur e fikin të tretën. Sipas tyre

⁵ Është interesant të vihet re këtu se si pos grave marrin pjesë në zbatimin e pokusheve edhe burrat.

vetëm tri sy kanë njerëzit, përkatësisht sytë e tyre mund të ndeshen vetëm në tri lloj ngjyrash: sy i zi, i bardhë dhe i shkruar. Me rastin e fikjes së gacës, kur përmendet ai sy që e ka marrë mësysh fëmijën, gaca zhërit (cingllon) më tepër dhe kështu dihet se cili sy e ka marrë mësysh, duke besuar se në këtë mënyrë fëmija u çlirua nga mësytë e syrit të lig. Me këtë rast gruaja që zbaton këtë pokush, njëkohësisht thotë: „Ç’pashi me soj, e lashi ktau; ç’pashi me bith, e marrshi me viti!” Pastaj e marrin një shoshë dhe në të futin tri lugë, tri ceza, një thikë, fshisën, mashën, kacinë, saxhakun, kandarin dhe mundësisht një krye dhelpre. Fëmijën e qesin te pragu i derës së dhomës dhe aty e lajnë, duke ia lëshuar ujin sipri nga shosha, ku kalon nëpër të gjitha këto vegla shtëpiake me ëllim që të keqen e fëmijës ta marrin lugët siç e marrin gjellën, ta pretë thika, ta fshijë fshisa, ta kapë masha, ta dëlirë kacia siç i dëlir lëmishtet etj. Duke e larë këtë fëmijë, thonë: „T’kçijat teposht me ujin, gjali, cauca, terma”. „T’kçijat ani praktik, t’majrat koni praktik”. Fëmijën e zënë në gjumë, kurse shoshën me të gjitha ato sende e kthejnë mbrapsht në hajat me qëllim që t’i kthehet prapë dhembja atij. Me këtë rast, thonë: „T’kçijat tiqe, t’majrat teka!” „Prap thkeft dhajmta!” Këtë ujë, me të cilin është larë fëmija, e derdhin në nevojtoare, duke thënë: „E keçja e marrt t’keçen!” Kur fëmija qan shumë, në katundet Novosellë, Rakovec e Sellcë të Keqe e marrin tojën e djepit të tij dhe e qesin diku në udhë, duke e shtrirë në atë mënyrë që të bëjë kryq me udhën, për ta kapërcyer shtazët (njerëzit s’e kapërcejnë se druajnë se mos po bën dikush magji e i zë) me qëllim që kështu t’i kapërcejë edhe vaji atij.

Nëse ka qenë dikush i huaj në shtëpi, përkatësisht nëse ka pasur aty mysafirë dhe, pas shkuarjes së tyre, fëmija nis e qanë me të madhe, atëherë mendohet se dikush prej tyre do ta ketë marrë mësysh atë. Për mësysh gjithnjë i fikin gaca fëmijës. Prandaj edhe në këtë rast për çdo njeri që e ka parë i fikin nga një gacë në ujë të ftohtë, duke përmendur emrin e secilit: „Mo t’ka marr msojsh filani.” etj. Kur një gacë zhërit në ujë më tepër se të tejrta, atëherë besohet se fëmijën do ta ketë marrë mësysh ai mysafir, emri i të cilit përmendet me këtë rast, dhe me këtë zbulim të syligut janë të sigurt se fëmija do të çlirohet nga mësytë dhe do të pushojë së qari. Pastaj i japin fëmijës të pijë pak ujë nga ai ku janë fikur gacat, duke e stërpikur me të njëkohësisht edhe kah kryet e fytyra me qëllim që t’i hiqet vaji e mësytë. Në fund këto gaca dhe ujin ku janë fikur ato i derdhin në një strehë të shtëpisë. Po qe se dyshojnë në ndonjë mysafir se do t’ua ketë marrë mësysh fëmijën, atëherë si të çohet e të shkojë ai, menjëherë e vënë fëmijën në vendin ku ka qenë ai ulur, duke besuar se kështu nuk do ta zërë atë mësyja, i kapërcen ajo.

Madje as nuk e lajnë fëmijën, foshnjën, deri sa është aty mysafiri: presin të shkojë ai e pastaj e lajnë, se po e pa lakuriq atë, besohet se merr mësysh. Ndër të tjera, për çështje mësysh ngrohin

ujë në një kusi dhe e qesin në një tepsi, ku vënë një thikë, tri lugë dhe një vorbë të re pa u ushtuar të kthyer përmbys. Pastaj marrin dhe fikin gaca në këtë ujë, duke kënduar dua të ndryshme. Nëse vorba me këtë rast e thith brenda ujin nga tepsia, mendojnë se fëmija ka marrë mësysh, prandaj marrin dhe e lajnë atë me këtë ujë, duke besuar se kështu i lahet mësyja. Por me këtë ujë ato e lajnë fëmijën edhe në rast të kundërt, kur vorba s'e merr ujin brenda.⁶ Në katundet Novosellë, Ratkovec e Sellcë të Keqe për çështje mësysh e sëmundjesh të tjera të ndryshme u japin fëmijëve të hanë edhe një lloj krimbesh të bardhë shumëkëmbësh fare të vegjël, të cilët gjenden ndër rrasa e gurë të mbuluar nga uji i vijave, përrenje dhe i lumenjve. Këta krimba johelmues i shypin mirë e mirë dhe, pasi i fryjnë te ndonjë grua, ia japin fëmijës që t'i hajë. Thonë se fëmija pastaj qetësohet e shërohet menjëherë. Fëmijëve për mësysh dhe sëmundjesh të tjera u japin të pinë edhe ujë prej lules së Qabes dhe prej tasit të Qabes, që është një lloj ene e shkruar me gjithfarë shkrimesh (jaziash) arabe, kryesisht dua.

Kur fëmija është i sëmurë nga epilepsia, për të cilën thonë në këtë anë se „a i kapërcajëm” ose „ber n'ato pun”, e mbështjellin me xharr⁷ dhe tri herë njëra pas tjetrës e futin në magje dhe e qesin nga ajo, duke besuar se bereqeti, buka e mielli, do t'ia largojnë këtë sëmundje të rëndë. Pastaj e thyejnë një shkop më dysh në prag të derës së shtëpisë dhe të dy gjysmat i fugin diku larg, duke besuar se kështu e thyejnë dhe e fugin edhe dhembjen e të këqijat e fëmijës së sëmurë. Pastaj i marrin teshat e këtij fëmije dhe e mbështjellin me to një gur, të cilin e fugin. Në atë vend ku bie guri, duhet t'i futin në tokë teshat e fëmijës së kapërcyer me qëllim që kështu ta varrosin edhe sëmundjen e tij.

Disa pokushe janë të lidhura me ecjen e fëmijës. Kur fëmija, ndonëse e ka kaluar motmotin, nuk është në gjendje të ecë fare apo normalisht, për shkak se kur ka nisur të ecë në fillim është rrëzuar e është vrarë dhe kështu nga frika që ka marrë e ka humbur të ecurit, nuk i jepet të ecë ose për arsye të tjera kryesisht shëndetsore, atëherë atë e ngarkojnë me krande dhe e fugin mbi mashën që t'i plasë frika e të fillojë të ecë. Ja si ndodh kjo. Në tri të shtunë rresht tri vajza të fejuara (t'dhanme) që i kanë prindërit gjallë, si duket për t'iu dhënë fëmijës të ecurit e të jetojë me nënë e me baba, në tre gumbuj plehu mbledhin krande, me të cilat e ngarkojnë fëmijën si kalin, duke ia lidhur barrën me tojën e djepit të vet. Njëra nga vajzat e tërheq fëmijën për tojë si kalin për kërpeshi, e dyta e mban për krahësh mos të rrëzohet, kurse e treta i shkon përmbas me një sëpatë në dorë, duke i thënë: „Hec se t'preva!”

⁶ Këtë pokush e zbatijnë edhe për shtazët, të cilat besohet se kanë marrë mësysh dhe me këtë ujë i stërpikin ose ua qesin në gjellë, në kripë, në krunde e në sende të tjera ushqimore, duke besuar se kështu do t'u prihet mësyja.

⁷ Një lloj veshje e zezë grash, me të cilën mbulohen ato për çështje të havales.

Kështu i thotë me qëllim që t'ia pretë frikën fëmijës e t'i lëshohet të ecurit. Në këtë mënyrë fëmijën e sjellin tri herë rreth e rrotull shtëpisë. Pastaj kështu në ngarkuar me dru fëmijën e merr njëra nga vajzat dhe e hip mbi mashën, kurse dy të tjerat presin poshtë. Vajza që ka hipur me fëmijën përmbi mashën, i thotë tri herë atij: „A do hecish, a t'flugja?” Mandej e lëshon fëmijën, të cilin e mbajnë në duar poshtë në strehë të mashnës dy vajzat e tjera që të mos bjerë në tokë e të mbytet. Fëmijën e rrokullisin kështu tri herë njëra pas tjetrës mbi pullazin e mashnës me qëllim që të tutet ai e t'i dalë frika për të mundur pastaj të ecë, sepse frika e heq frikën (fragja e çet fragjën). Pas kësaj e shkarkojnë fëmijën dhe me ato krande kallin zjarr për t'i ngrohur ujë, me të cilin e lajnë jashtë në lëmë te grumbulli i plehut me qëllim që frikën t'ia djegin, t'ia lajnë dhe t'ia hedhin në pleh, e keqja ta marrë të keqen. Një numër pokushesh janë të lidhura edhe me të folurit e fëmijës, të cilat kanë për qëllim që t'ia mundësojnë atij këtë dhunti natyrore, përkatësisht t'i ndihmojnë në artikulimin e tingujve dhe në shqiptimin e fjalëve, natyrisht atij fëmije që s'flet fare ose që ka pengesa në këtë drejtim. Për ndonjë fëmijë që s'flet me kohë, që i ka mbushur vjetët, por s'është në gjendje të shqiptojë asnjë fjalë, mbushin ujë pa folur në një gjygyt të bakërt qysh në mbrëmje dhe të nesërmen në mëngjes herët para agimit ende pa u zgjuar njerëzit nga gjumi, ende pa filluar të flasin, e marrin fëmijën dhe ujin e pafolur e dalin në një udhëkryq për të dëgjuar cicërimën e zogjve të mëngjesit. Me të dëgjuar cicërimën e parë të tyre, menjëherë i japin fëmijës të pijë ujë të pafolur me nijet që të filloj të fletë mirë e bukur ashtu siç cicërojnë zogjtë. Gjithashtu për fëmijën që s'flet fare (pa gjoj) e me qëllim që t'i vijë goja e të fillojë të flasë, mbushin ujë në tri çesme të reja, ende pa u lëshuar, dmth. ujin e parë që rrjedh nga to me rastin e çeljes së tyre, dhe ia japin ta pijë me nijet që t'i çilet goja e të flasë ashtu siç çilet çesmja e re e rrjedh uji i saj. Fëmijës që s'flet i japin të hajë edhe pak mish të deveve të sjellë nga haxhillarët, duke besuar se mishi i kësaj kafshe të bekuar nga profeti i fundit i islamizmit do të ketë efekt pozitiv që t'ia çelë gojën fëmijës e të flasë. Kur fëmija nuk flet mirë, nuk i shqipton të plota fjalët, bëlbëzon, i merret goja (asht peltek) ose është thuthaç (nauk gjoditën majr) i japin të pijë tri lugë ujë nga grosha kur dan valë, duke i thënë: „Sikur xhi dan gjrosha val, ç'ashtau taj t'i dajsh llafet”.

Një rëndësi të veçantë në jetën e fëmijës kanë edhe dalja e dhëmbëve, prerja e flokëve dhe e thonjve dhe ndarja nga gjiri, ndërprerja e të thithurit të qumështit të së ëmës, rreth të cilave po ashtu janë krijuar një varg pokushesh të ndryshme. Kur fëmijës i dalin dhëmbët e parë ziejnë kokrra të grunjta (viën koka gjruni) me qëllim që fëmijës t'i bëhen dhëmbët e vegjël e të bukur si kokrrat e grurit. Madje disa kokrra të ziera i ngjesin në një pe dhe ia varrin në qafë që t'i mbajë disa ditë. Aty-këtu edhe kokrrat e dhëmbëve i derdhin fëmijët nëpër lagje (mahall-a), për të cilën gjë marrin

si shpërblim ndonjë kokërr vezë, ndonjë dinar, ndonjë copë bukë u futin në enë që të mos ua kthejnë thatë atë etj. Aty këtu sipas katundeve (në Shipkovicë) kush ia sheh i pari dhëmbët fëmijës është i detyruar sipas zakonit që t'ia presë një këmishë dhe me këtë rast familja e fëmijës bëjnë sytliaç me qëllim që atij t'i bëhen dhëmbët e bardhë e të imët si orizi. E ftojnë të hajë tëmbëloriz edhe atë njeri që ia ka parë dhëmbët fëmijës i pari. Më vonë kur fillojnë t'i ndërrohen dhëmbët fëmijës, dhëmbët e vjetër, të qumështit, ia fugin mbi pullaz të shtëpisë, duke thënë: „Laskër, laskër na t'vetrin, bema t'rivin”. Ose: „Laskër, laskër, na d'drujtin, bema t'hekërtin”.

Deri sa bën një motmot fëmija, nuk ia presin flokët dhe thonjtë, sepse, sipas tyre, nuk është mirë, nuk bën. Madje për thonjtë thonë se fëmija duhet t'i mbajë, sepse ai mbrohet me ta, nëse vijnë për ta shituar shpirtërat e këqij, qoftëlargët. Përndryshe, në krye të motmotit fëmijës ia presin edhe flokët edhe thonjtë. Flokët duhet t'ia pretë dikush që është i ri, në rritje, i shëndetshëm, i bëshëm dhe dolëmirë (xhumert) e që i ka prindërit gjallë me qëllim që edhe flokët t'i rriten fëmijës e të ketë shëndet si „berberi” i tij e të jetojë me nënë e me baba. Në këtë anë flokët ua presin fëmijëve, si djemve, ashtu edhe vajzave, vetëm përreth ballit dhe pak prapa kah qafa. (Në MT deri shtatë tetë vjet, si djemtë, ashtu edhe vajzat, kanë frizurë të njëjtë me flokë të gjatë dhe është bukur vështirë të dallohen përkah gjinia sipas flokëve). Flokët e prera i qesin në ujë, duke i fugur në ndonjë lumë, përrua ose vijë me qëllim që të rriten dhe fëmijëve t'u ecë shëndeti si uji. Flokët nuk bën të shkulet, sepse besohet se fëmijës i dhemb kryet dhe i bien flokët. Për thonjtë nuk është me rëndësi se kush ia pret fëmijës, kryesisht e ëma e tij. Thonjtë e prerë për herë të parë ia mbështjellin në një letër dhe ia çojnë në strehë të xhamisë ose të shkollës (mektepit), ku i rrëmihin në tokë me qëllim që fëmijës t'shkojë shkolla, të mësojë mirë, të bëhet hoxhë, mësues (i diçëm) etj. Pikërisht për këtë qëllim grimcat e thara të kërthizës së fëmijës i ruajnë dhe atë ditë që ai shkon në shkollë për herë të parë, marrin dhe e lajnë me to me qëllim që t'i ecë shkolla, të mësojë mirë.

Fëmijët i ndajnë nga gjiri kryesisht nga koha kur fillojnë të hanë me dorën e vet e deri në moshën tri vjeçare, prej një motmot e deri tre vjet. Disa gra që kanë bërë shumë fëmijë dhe nuk duan më të lindin të tjerë e mbajnë fëmijën më gjatë të thithë me qëllim që të ruhen nga barra e re, gjë që të një numër sosh është vërtetuar edhe nga gjinekologjia. Përndryshe, fëmijës ia ndërprejnë qumështin kah fundi i javës apo i muajit (kur a hana n't' sosmit), sidomos në stinën e vjeshtës, në fund të motmotit, me qëllim që kështu të marrë fund sa më shpejt ndarja e fëmijës nga gjiri, ta harrojë sa më shpejt të thithurit e qumështit. Në muajin qershor nuk i ndajnë fëmijët nga gjiri, sepse, sipas tyre, ky muaj është i gjakut, prandaj edhe fëmijët bëhen të gjakut, bëhen, të rreptë (t'sert), të këqij, qajnë shumë dhe s'e harrojnë gjirin. Nuk

kemi mundur të kuptojmë se pse qershorin e quajnë muaj të gjakut. Ndofta për arsye se në këtë muaj dalin qershitë, është muaj i qershive, nga e ka marrë edhe emrin, që kanë ngjyrë gjaku dhe sipas kësaj cilësie (ngjyre) të tyre të ngjashme me atë të gjakut të jetë quajtur kështu edhe ky muaj? Në të shumtën e rasteve fëmijën e ndajnë nga gjiri me „sabër” të sjellë nga Qabja me anë të haxhillarëve.

Kjo është një lloj materjeje e ngurtë ngjyrë kafeje dhe me shije të idhët, por johelmuese. Në kontakt me ujin ajo lëshon ngjyrë. Me këtë materje e ëma e fëmijës i lyen majat e sisëve me qëllim që ai të mos e marrë më sisën nga idhtësia dhe të frikohet nga ngjyra e saj. Njëkohësisht, sabrin ia varin në qafë fëmijës ose ia vënë në krah të djathtë që të bëjë durim e të mos dalldiset shumë pas gjirit, qumështit. Fëmijën e ndajnë nga të thithurit edhe me anë të specit, me të cilin i hyejnë gjinjte, por më rrallë, sepse kështu besojnë se fëmija bëhet i egër. Ndër të tjera, fëmijën e ndajnë prej qumështit, duke vënë në gji edhe të shtypur gacash, të djegura nga leshi (shkrumb) ose drejt për drejt lesh të zi e të tjera materje me shije të keqe e ngjyrë të zezë me qëllim që fëmija në këtë mënyrë të trishtohet nga shija e të frikohet nga ngjyra e zezë për të mos e kërkuar më gjirin. Atë ditë që e ndajnë fëmijën nga të thithurit, bëjnë gurabija me qëllim që ai të mashtrohet pas tyre e ta harrojë gjirin.

Si në shumë krahina të tjera shqiptare, ashtu edhe në MT është zakon, si u pa edhe më lart, që fëmijën e parë sidomos ta dhurojnë me të holla, ta daritin me ndonjë dinar, madje jo vetëm ata që shkojnë te ajo familje për lindje të fëmijës, por edhe të tjerët që i qet puna të shkojnë atje. Me këto para të mbledhura i blejnë fëmijës një gjygyim ose një tepsi të bakërt me qëllim që fëmija të jetojë aq shumë sa jeton bakri. Përndryshe, gjygyimin ose tepsinë e ruajnë mirë dhe në të ardhmen, kur të rritet fëmija, ato i mbeten si kujtim i kësaj ngjarjeje, i lindjes së tij, gjatë gjithë jetës.

Rreth këngëve të djepit në MT (Luli lulat)

Sikur nëpër krahinat e tjera shqiptare, ashtu edhe në MT për ta vënë fëmijën në gjumë e përkundin, duke i kënduar këngë të ndryshme. Me këtë rast këngë të këtilla i këndojnë fëmijës kryesisht personat e gjinisë femrore, që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të në radhë të parë gjyshja (lokja) e tij, e ëma, motrat etj. Përndryshe, si çdo kund tjetër ndër viset tona⁸ edhe në MT nënat e kësaj ane përmes këngëve të djepit shprehin jo vetëm dashurinë e thellë ndaj fëmijës e dëshirat që ndiejnë për të që mos i ndodh ndonjë e keqe, që ai të rritet me prindër, të jetojë gjatë, të jetë i shëndetshëm e i lumtur, të bëhet i mençur, punëtor e trim dhe të ketë edhe cilësi të tjera të mira. Në këngët e djepit të MT, ndër

⁸ *Historija e letërsisë shqipe I—II*, Prishtinë (ribotim) 1968, f. 40—41.

të tjera, pasqyrohet besnikërisht edhe realiteti shoqëror, gjendja materiale dhe botëkuptimet e banorëve të kësaj ane. Duke qenë se mjeshtëria kryesore e malësorëve të Tetovës është blegtoria, pjesën më të madhe të këngëve të djepit e përshkon dëshira e nënës që i biri t'i bëhet bari, qehaja e prodhues i mirë i bulmetit, të cilin e shesin për të siguruar bukën.

*Luli luli nana gjalin,
luli luli gjal përmallin:
do ma kllote nanës kalin,
do ma baje nanës pazarin.
Toj t'kam nana gjal për shpoj,
do t'baj nana hajlakçoj;⁹
do t'baj nana shulegjar,¹⁰
t'majsh buk me magjar.
Luli luli gjalin tem:
da baj nana çoban me dhen,
çoban me dhen, çoban me shterpa,
do m'i kllote n'Reka t'Epra;¹¹
çoban me dhen, çoban me pllaja,
do m'i kllote kah Rrafshajtina;¹²
çoban me dhen, çoban me shqerra,
do m'i kllote kah Sehadërja;¹³
çoban me dhen, çoban me desh
do m'i kllote n' Zhinibegj.¹⁴*

Në jetën e malësorëve të Tetovës rol me rëndësi luan kurbeti, i cili zë një vend të posaçëm në këngët e djepit.

Për shkak të vendit të varfër malor, nënat e MT theksojnë nevojën për një jetë më të begatshme, të paktën për fëmijët e tyre, prandaj dhe i këndojnë:

*Gjepa me lule, gjepa me lule,
do ta rrajti gjalin me voe pule.
Gjepa me pare, gjepa me pare,
do ta rrajti gjalin me shiqerpare.
Gjepa me tela, gjepa me tela,
do ta rrajti gjalin me llokumshiqera.
Ha bre bir mos u azdis,
do t'baj nana përzhenic.
Ha bre bir mos u përdhos,
do t'baj nana përshesh me koss.*

⁹ Me fjalën „hajlakçoj-a” e quajnë një njeri që punon me kuaj: i ngarkon i shkarkon etj.

¹⁰ Me fjalën „shulegjar-i” e quajnë bariun që i ruan shtjerrat, nga sheleg.

^{11, 12, 13, 14} Të gjithë këta emra janë toponime të katundit Bozovcë.

Nënat i duan shumë fëmijët e tyre, të cilët për to janë shpesh, gjërat më të bukura e më të dashura si zogu, pëllumbi, qengji, dashi, ari etj., me të cilat i krahasojnë:

*Luli luli nana gjalin,
luli luli gjal sugjarin.
Luli luli do t'përkuni,
të ma zane gjalin xhumi;
të ma zane xhumi amël
do t'i baj përshesh me tamël.
Hajde xhum e rrajtma shaum,
merrma zogj e berma pllaum;
hajde xhum e rrajtma t'madh,
merrma kinxh e berma dash.*

Në MT si u theksua edhe më lart djali çmohet më shumë se vajza / atë e duan më shumë se këtë. Kujdesi për djalin në çdo pikëpamje është shumë më i madh se për vajzën. Lindja e djalit e gëzon familjen, kurse ajo e vajzës jo, sepse vajza është „der'e huj”, ndërsa djali është „direki i shpajsë: ai është i udhës e i punës, i kurbetit, i fitimit e interesit, ushqyesi e mbrojtësi i familjes, e cila vetëm në të mbështet shpresën e jetës.¹⁵ Prandaj, kur e futin në djep që të flejë, të rritet e të bëhet i madh, djalin e përkundin, duke i kënduar këngë të ndryshme.

Kur fëmija nis të ecë, pa marrë parasysh nëse është djalë apo vajzë, në MT e këndojnë:

*Tatas, tatas lit e lit,
hecen NN si xhelit.¹⁶*

Siç shihet edhe nga këto këngë djepi të dhëna më sipër, në MT këngët që këndohen për ti' zënë fëmijët në gjumë fillojnë rregullisht me fjalët „luli, luli”, si duket nga serbokroatishtja „ljuljati, ljuljam”, që do të thotë „përkund, lëkund”.¹⁷ Edhe në MT këngët e djepit janë improvizime të rastit dhe të shkurta, të cilat i krijojnë aty për aty nënat, duke i përkundur fëmijët e tyre, por edhe si të trashëguara gojë më gojë. Me zënafillë ato janë shumë të lashta, por vazhdimisht ndryshojnë me ndërrimet e marrëdhënieve ekonomike e të përparimeve arsimore e kulturore të një shoqërie.¹⁸

Në fund po theksojmë se në këtë punim është bërë vetëm një përpjekje të përfshihen ato pokushe e këngë më të përgjithshme e më të qëndrueshme për katundet e kësaj ane e që paraqesin interes të shumëfishtë për studime etnografike, sociologjike, letrare etj.

¹⁵ Pavllo Gjidede — *Një vështrim mbi ninullat në lumin e Vlorës*, Konferenca e dytë e studimeve albanologjike III, Tiranë 1970, f. 74.

¹⁶ Nga turqishtja „cilit”, që do të thotë „shumë shpejt”.

¹⁷ *Fjalor serbokroatisht — shqip* Prishtinë 1974, f. 348.

¹⁸ Demush Shala — *Letërsia popullore shqiptare*, Prishtinë 1974, f. 23.

Fadil Sulejmani

QUELQUES NOTES CONCERNANT LA NAISSANCE DANS LA MALËSIE
DE TETOVA (II)

Résumé

Dans la région montagneuse de Sharr de Tetova tout le procédé du déroulement de la naissance peut être séparé en différentes parties ou phases. Il commence avec la période de grossesse et se prolonge avec les berceuses chantées pour endormir l'enfant selon les rites, les événements et les diverses cérémonies plus ou moins magiques en l'honneur de la naissance ou dans le but de protéger l'enfant et la mère du mal. Certaines phases de ce rite familial, à l'exception de la grossesse, du temps de l'accouchement et de la plus jeune enfance qui ont fait l'objet d'une étude dans le précédent numéro de cette revue, restent à étudier, il s'agit des „Kokrrat”, „Babinat” et berceuses.

Kokrrat est une cérémonie de peu d'ampleur organisée à l'occasion de la naissance de l'enfant en signe de joie. Son nom lui vient des grains de maïs qu'on fait bouillir à cette occasion pour augmenter le bonheur de l'enfant, pour qu'il grandisse dans sa famille et soit comblé de toutes bénédictions.

Babinat est aussi une cérémonie joyeuse qui se déroule à l'occasion de la naissance, surtout du garçon en organisant une plus grande fête que pour les Kokrrat. La cérémonie des Babinat se fait seulement pour les premiers enfants, elle a lieu à partir de la première semaine de la naissance de l'enfant jusqu'à ce qu'il ait un an. Aux cérémonies des Kokrrat et des Babinat ne sont invitées que les femmes; elles arrivent portant des cadeaux pour l'enfant et la mère. Aux invitées on offre à manger et à boire. Durant la cérémonie des Babinat il n'est pas coutume de chanter, mais dans de nombreux cas si l'on fête la naissance d'un enfant mâle on rompt le règlement en chantant et jouant.

Lorsque le bébé commence à balbutier, à faire ses premiers pas et à experimenter le milieu qui l'environne les parents et les proches membres de la famille lui donne alors le nom d'enfant. Afin que l'enfant grandisse bien, qu'il soit protégé du mal et du mauvais oeil et soit guéri de toutes maladies les gens de cette région ont créé une série de coutumes, de procédés fétichistes et autres superstitions.

Pour endormir l'enfant les femmes, principalement la mère, la grand-mère et la soeur chantent des berceuses. Elles expriment ainsi à la fois leur amour profond envers l'enfant et les souffrances qu'elles endurent pour lui de peur qu'il ne lui arrive quelque chose de mauvais, et souhaitent aussi qu'il grandisse avec les parents, qu'il vive longtemps, qu'il soit heureux, bien portant intelligent, travailleur, courageux et qu'il ait aussi d'autres bonnes qualités. Dans les berceuses de la Malesi de Tetova se reflète fidèlement la réalité sociale, la situation matérielle et la conception de l'existence des habitants de cette région.

